

# AKTI I THEMELIMIT TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"INFORMATRIKS" sh.p.k.

## NENI 1

Sot ne date 01/II/2022 themelohet shoqeria tregtare me pergjegjesi te kufizuar "INFORMATRIKS" sh.p.k., mbeshtetur ne ligjin nr.9901, date 14.4.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" te ndryshuar, ligjin nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", ligjin nr. 9121, date 28.7.2003, "Per Mbrojtjen e Konkurrences", Kodin Civil dhe Kodin e Punes me ortak themelues si vijon:

**Besmir Kodra**, i biri i Lulzim, i datëlindjes 02.03.1986, lindur në Berat dhe banues në Tiranë, i identifikuar nga Karta e Identitetit me nr. Personal I60302052P, madhor dhe me zotësi të plete juridike per te vepruar;

**Alfred Çejku**, i biri i Mersinit dhe Marjanës, i datëlindjes 06.08.1991 lindur në Kukës dhe banues në Tiranë, person madhor, me zotesi te plete juridike per te vepruar, identifikuar nga nr. Personal J10806097W.

## NENI 2

### SELIA E SHOQERISE

2.1. Selia e Shoqerise ndodhet në Njësinë Administrative nr. 7, Rruga "Frederik Shiroka", Kulla 3, hyrja për biznesin, kat 2, Shkalla 3, ap. 7, ZK 8210, Tiranë.

2.2. Shoqeria ka te drejte te hapi filiale te tjera brenda territorit te Republikës se Shqiperise ashtu edhe jashte vendit, ne varesi te selise Qendrore qe ndodhet ne Tiranë.

## NENI 3

### KOHEZGJATJA E AKTIVITETIT TE SHOQERISE

Kohëzgjatja e shoqerisë do të jetë e pakufizuar dhe fillon nga momenti i regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me përjashtim të rasteve kur mbaron sipas parashikimeve në ligj ose kur vendos Asambleja e Pergjithshme.

## NENI 4

### OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

- Zhvillim, dizenjim dhe mirëmbajtja e Web-faqeve;
- Zhvillim, dizenjimin dhe mirëmbajtja e platformave të shitjeve online;
- Ofrimin e shërbimit të marketingut online/dixhital dhe studimeve të tregut;
- Zhvillim, implementim dhe mirëmbajtje të sistemeve dhe programeve në fushen e teknologjisë se informacionit;
- Projektim, ndërtim dhe mirëmbajtje në fushën e telekomunikacionit si rrjete WAN/LAN, sisteme sigurie, etj;
- Shërbime të dizenjimit, printimit, publikimit, botimit dhe prodhime të ndryshme të shtyshkrimit;

1

- Tregti, eksport-import, furnizime, instalime dhe mirëmbajtje e pajisjeve elektronike, informatike, audiovizive, etj.
- Blerja e çdo lloj produkti nga te gjitha faqet e internetit, shqiptare dhe te huaja.
- Ofrimi i sherbimit te marketingut te çdo lloj produkti/biznesi ne faqet e internetit, rrjetet sociale dhe te gjitha format e tjera konform legjislacionit ne fuqi.
- Importi - eksporti, shitja me shumice dhe pakice i produkteve tekstile, veshje te te gjitha llojeve.
- Importi - eksporti shitja me shumice e pakice e pajisjeve elektrike, elektronike, lende te para per industrine, materiale ndertimi dhe hidrosanitare, pajisje zyrash kancelari, pjese kembimi, auto dhe makineri te cdo lloji, pajisje teknologjike etj.
- Transport i mallrave brenda dhe jashte vendit.
- Si dhe çdo veprimtari tjeter ekonomike qe do te konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme per realizimin e qellimit te shoqerise dhe qe nuk bie ndesh me legjislacionin Shqiptar ne fuqi.

## NENI 5

### KAPITALI I SHOQERISE

1. Kapitali i shoqërise ka vlerën 10.000 lekë i cili ndahet në 2 kuota, secila me vlerë respektive.
2. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Në rast zmadhimi te kapitalit nëpërmjet shtimit te kuotave te reja, ortakët kanë te drejtë e përparësise në nënshkrim, proporcionalisht me shumën e kuotave të tyre, e drejtë nga e cila ata mund të heqin dorë.
3. Kapitali i shoqërisë, mund të zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Zvogëlimi i kapitalit i prek të gjithë ortakët në të njëjtën masë ndaj kuotave të kapitalit që ata përfaqësojnë. Kapitali nuk mund te zvogelohet nen kufirin minimal që lejon ligji "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

## NENI 6

### KONTRIBUTET

Kapitali i shoqërisë, zotërohet nga ortakët e shoqërisë **Besmir Kodra** dhe **Alfred Çejku** si vijon:

Ortaku **Besmir Kodra** zotëron 25% të të gjithë vlerës së kapitalit, të përbërë nga 1 kuotë, me vlerë totale prej 2.500 lekë;

Ortaku **Alfred Çejku** zotëron 75% të të gjithë vlerës së kapitalit, të përbërë nga 1 kuotë, me vlerë totale prej 7.500 lekë;

Vlera e kapitalit themeltar të shoqërisë është shlyer plotësisht me kontributin e ortakëve sipas raportit të paraqitur më sipër.

## ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

1. Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe vendimet e asamblesë se Pergjithshme, dhe disponon një numër votash të barabartë me kuotat e kapitalit që ai zoteron.
2. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga bashkëshorti ose një person tjeter i zgjedhur prej tij, me kusht që këta të janë autorizuar me prokurë (perjashtohet perfaqësimi i një ortaku nga një ortak tjeter apo administratori i shoqerise).
3. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
4. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëtin rend dite.
5. Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratorët, ekspertet kontabel të autorizuar, po qe se ka të tille, nga likuiduesit apo ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë. Keta ortake mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës. Njoftimi do te behet me shkresë, ose nepermjet postes elektronike.
6. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
7. Nese në kundërshtim me pikën 5 të këtij nenii, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë te procedoje sipas ligjit ne fuqi "Per Tregtaret dhe Shoquerite Tregtare":
8. Lajmërimi për mbledhjen e asamblesë se pergjithshme rregullisht bëhet nga administratorët.
9. Asambleja e Pergjithshme merr vendime per ceshtjet e meposhtme dhe eshte perjegjese per to:
  - a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë; ndryshimet e statutit;
  - b) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve te shoqerise;
  - c) Emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;

- d) Përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likuiduesit dhe të ekspertëve kontabël te autorizuar;
- e) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- f) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë. (pas marrjes dhe shqyrtimit te dokumentacionit perkates);
- g) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit (pas marrjes dhe shqyrtimit te dokumentacionit perkates);
- h) Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- i) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë e në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- j) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- k) Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- l) Cështje të tjera të parashikuara nga ligji.

10. Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Pergjithshme regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënët e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

11. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) Shpérndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) Investime;
- d) Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

12. Vendimet e parregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.

13. Sipas rëndësisë së vendimeve, mbledhja e asamblesë se per gjithshme mund të jetë e zakonshme ose e jashtëzakonshme.

14. Asambleja per gjithshme vendos me shumice te zakonshme për cështje të tillë si emërimi ose shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabel të autorizuar dhe likuiduesve, miratimi i raporteve të administrimit dhe të kontrollit, miratimi i pasqyrave financiare vjetore. Asambleja mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 50% te kuotave dhe vendimet merren me me shume se gjysmen e votave te ortakeve pjesemarres.

15. Asambleja e per gjithshme vendos me shumice te kualifikuar për cështje të tillë si ndryshimet e statutit, zvogëlimi dhe zmadhimi i kapitalit themeltar, kalimi tek të

tretët, zgjatja e kohës së veprimtarisë së shoqërisë apo likuidimi i saj, shndërimi i shoqërise me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri të formave të tjera, ndarja e fitimeve si dhe cdo cështje tjetër që parashikohet në ligj.

- 16.** Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendur në kete pikë, të këtij nenit, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

## NENI 8

### ADMINISTRIMI

1. Shoqëria administrohet nga një ose me shume administratorë të cilët janë persona fizike të zgjedhur brenda bashkësisë së ortakëve apo dhe jashtë saj.
2. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emëritimit, eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje, me përjashtim të rastit të dorëheqjes ose të shkarkimit të parakohshëm para mbarimit të afatit. Shkarkimi i administratorëve nga organi kompetent mund të bëhet në cdo kohë.
3. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
4. Administratorët emërohen dhe shkarkohen me vendim të asamblese se përgjithshme sipas parashikimit ne kete statut.

## NENI 9

### KOMPETENCAT E ADMINISTRATOREVE

1. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
  - a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
  - c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
  - e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrëthanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

5

- g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
  - h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
2. Administratorët janë të detyruar të thërrasin asamblenë e përgjithshme persa parashikon ky statut ose ligji.
  3. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

## NENI 10

### EMERIMI I PARE I ADMINISTRATOREVE

Administrator i shoqërisë për periudhën 5-vjeçare emërohet Z. **Alfred Çejku i** identifikuar me Nr Personal J10806097W.

## NENI 11

### EKSPERTE KONTABEL TE AUTORIZUAR

1. Në rast nevoje si dhe kur kërkohet nga ligji, kontrolli finansiar dhe aprovimi i llogarive vjetore kryhet nga një ekspert kontabel i autorizuar, i emëruar për dy vite financiare me mundësi rizgjedhjeje nga asambleja e per gjithshme me shumice te zakonshme.
2. Shkarkimi i ekspertit kontabël të autorizuar vendoset në të njëjtat kushte si emërimi i tij, në rast se vërehen gabime, abuzime ose bëhet e pamundur kryerja e detyrës.

## NENI 12

### E DREJTA E VOTES

Cdo kuote jep te drejten e nje vote. Cdo ortak votat qe ka mund ti japi vetem ne uniformitet.

## NENI 13

### E DREJTA PER TE KALUAR REZOLUTE

Asambleja e per gjithshme mund te miratoje rezolute pa plotesuar kriteret e njoftimit ne kete statut apo ne ligj. Qe te miratohet nje rezolute ne mbledhjen e asamblese se per gjithshme duhet te jene te pranishem te gjithe ortaket personalisht dhe ta votojne ate ne menyre te unifikuar.



## **NENI 14**

### **ZHVILLIMI I SHOQUERISE**

Shoqeria mund te ndryshoje emertimin e saj, seline ligjore, objektin, mund te zmadhoje apo te zvogeloje kapitalin themeltar, mund te pranoje ose te largoje ortake.

## **NENI 15**

### **MARREDHENIET E PUNES NE SHOQERI**

Shoqeria do te perpiloje dokumentet perkatese per punesimin e personave te trete duke respektuar dispozitat e Kodit te Punes.

## **NENI 16**

### **VULA E SHOQUERISE**

Shoqeria ka vulen e saj ne madhesi te zakonshme me tekstin perreth saj.

## **NENI 17**

### **FITIMI I PEROSNALITETIT JURIDIK**

Shoqeria do te rregulloje veprimtarine e saj edhe me Statutin e saj, i cili pasi te nenshkruehet nga ortakët themelues do te fitoje personalitet juridik ne diten e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

## **NENI 18**

### **BILANCI DHE FITIMI**

18. 1. Viti finanziar fillon më datë 1 Janar dhe përfundon më datë 31 Dhjetor të çdo viti.

18.2. Llogaritë vjetore, inventari raportet mbi operacionet e viti finanziar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabël, miratohen nga asambleja e përgjithshme e shoqërisë.

18.3. Miratimi i dokumenteve mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit finanziar.

## **NENI 19**


### **FUNKSIONIMI I SHOQUERISE**

Rregullat per funksionimin dhe drejtimin e shoquerise pervec ketij Akti Themelimi jane te percaktuara ne Statutin e Shoquerise.

## **NENI 20**

### **ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE**

Te gjitha mosmarreveshjet me organet shteterore, personat juridike e fizike vendas e te huaj, do te zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë sipas legjisacionit ne fuqi.



**NENI 21**  
**DISPOZITA TE TJERA**

Ky akt themelimi perpilohet ne tre kopje, duke patur secila kopje fuqi te plote ligjore.

Autorizohet Z. Alfred Çejku me numër ID J10806097W për regjistrimin e shoqërisë pranë QKB-së.

Akti i themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortakët themelues të Shoqerise "INFORMATRIKS " sh.p.k

**THEMELUESIT E SHOQËRISË**

Besmir Kodra

  
Besmir Kodra

Alfred Çejku

  
Alfred Çejku